

VENDIM
Nr. 81, datë 22.6.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014 PËR AKOMODIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE TË VENDIMIT NR. 80, DATË 15.6.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të neneve: 7, 8 pika 2 germa “b”, “ç” dhe “dh”, nenit 26 pika 1 dhe 27 pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 pika 2 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, dhe neneve 112, 121 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2012,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani